

NJOFTIM

**Qendra e Personel Rekrutimit,
do të rekrutojë kandidatë për ushtarë/detarë aktivë në FA**

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për ushtarë/detarë aktivë:

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të mos jetë në ndjekje penale, në proces gjykimi penal apo i dënuar nga gjykata për vepra penale.
- Të ketë figurë të pastër morale dhe të mos ketë probleme me drogën dhe alkolin.
- Të mos ketë probleme me deportimin.
- Moshë minimale e rekrutimit është 18 vjeç. Në momentin e titullimit ushtar/detar aktivë nuk duhet të ketë mbushur moshën 27 vjeç, ndërsa për personelin mjekësor moshën 32 vjeç.
- Të ketë kryer arsimin minimumi 9-vjeçar
- Të ketë gjatësinë trupore mbi 165 cm për meshkujt dhe mbi 160 cm për femrat.
- Të jetë vlerësuar i aftë nga Komisioni Mjekësor Ushtarak.
- Të ketë rezultuar pa probleme gjatë verifikimit të kushtit të sigurisë të kryer nga strukturat përgjegjëse.

Dokumentacioni që do të paraqesin kandidatët për ushtarë/detarë aktivë:

- Kërkesë me shkrim.
- Fotokopjen e kartës së identitetit.
- Dy fotografi të përmasave 4 x 6 cm dhe dy fotografi të përmasave 9 x 12 cm.
- Fotokopjen e noterizuar e dokumentit të përfundimit të arsimit 9-vjeçar/parauniversitar të vërtetuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale, ose atë të arsimit të lartë.
- Diplomë, dëshmi apo certifikatë për aftësitë profesionale (nëse ka), të noterizuara.
- Raportin mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes në Qendrën Shëndetësore të vendbanimit të kandidatit, ku deklorohet se kandidati është i aftë për punë.
- Ekzaminimet mjekësore për agjentët infektivë (Hepatit B, Hepatit C, HIV/AIDS, Sifiliz) dhe grupin e gjakut të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo Drejtoritë e Shëndetit Publik.
- Kandidati i shpallur fitues, brenda 2 javëve, duhet të sjellë në Qendrën e Personel Rekrutimit edhe dëshmi penaliteti; vërtetim nga prokuroria; vërtetim nga gjykata.

Informacion më të detajuar mund të merrni edhe pranë seksionit të rekrutimit të qarkut.

Aplikimi bëhet personalisht pranë zyrës së Pritjes në Qendrën e Personel Rekrutimit.

Periudha e regjistrimit të kandidatëve deri më 01/07/2021

0692256444

Adresa: Qendra e Personel Rekrutimit, Rruga e "Dibrës" (Ish-Shkolla e Bashkuar), Tiranë.

Kontakt: + 355 42 348 588

Adresa e Facebook
Qendra e Personel Rekrutimit

<http://www.mod.gov.al>

